



Bazuar në nenin 35, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, të Ligjit Nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 77/16 gusht 2010), si dhe në pajtim me nenin 8, paragrafi 3, dhe nenin 42 Ligjit Nr. 04/L-018 për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 4/14 korrik 2011), Bordi i Bankës Qendrore, në mbledhjen e mbajtur më 12 qershor 2020, miratoi këtë:

RREGULLORE PËR ZBATIMIN E SISTEMIT BONUS-MALUS

Neni 1

Qëllimi dhe fushëveprimi

1. Kjo rregullore përcakton mënyrën e zbatimit dhe përlogaritjes së primit duke përfshirë sistemin bonus-malus ashtu siç është e përcaktuar në nenin 8, paragrafi 3, të Ligjit Nr. 04/L-018 për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia.
2. Kjo rregullore aplikohet nga të gjithë siguruesit dhe degët e siguruesve të jashtëm të licencuar në Republikën e Kosovës për shitjen e sigurimit të detyrueshëm nga autopërgjegjësia.
3. Kjo rregullore nuk aplikohet për shitjen e sigurimit kufitar nga autopërgjegjësia.
4. Siguruesit obligohen të aplikojnë këtë rregullore vetëm për rastet e lëshimeve të policave të sigurimit të detyrueshëm nga autopërgjegjësia për personat fizikë.
5. Zbatimi i sistemit bonus malus për personat juridikë rregullohet nga vetë siguruesit ose Byroja Kosovare e Sigurimit.

Neni 2

Përkufizimet

1. Termat e përdorur në këtë rregullore kanë kuptim të njëjtë siç përcaktohen në Ligjin Nr.04/L-018 për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia dhe/ose siç janë përkufizuar në vijim për qëllime të kësaj rregulloreje:
 - 1.1. **Sistemi Bonus-Malus** - është sistemi i cili zbatohet si korrektues i lartësisë së primit të sigurimit të autopërgjegjësisë, bazuar në historikun e dëmeve të të siguruarit (policëmbajtësit).

- 1.2. **Mjet motorik** - është mjete që lëviz në tokë me anë të fuqisë mekanike, por jo mbi shina, rimorkioja dhe gjysmë rimorkioja, të bashkuara ose jo me mjetin motorik tërheqës, për të cilat parashihet të regjistrohen dhe pajisen me dokument regjistrimi.
- 1.3. **Polica e sigurimit** - është kontrata e sigurimit nga autopërgjegjësia, respektivisht certifikata e standardizuar e sigurimit e nënshkruar nga siguroesi dhe i siguruari me të cilën provohet kontraktimi i sigurimit të autopërgjegjësise.
- 1.4. **I siguruar** - është policëmbajtësi, interesi pasuror i të cilit është siguruar në rast përgjegjësie nga përdorimi i mjetit motorik.

Neni 3 **Bonusi dhe malusi**

1. Secilit të siguruar në Kosovë, që ka kontratën (policën) e sigurimit të detyrueshëm nga autopërgjegjësia me afat të paktën një vit, niveli i primit i caktohet sipas shkallëve të sistemit bonus-malus, varësisht nga fakti nëse në periudhën e kaluar të sigurimit (vëzhgimit) ka pasur dëme të deklaruara apo jo.
2. Për qëllime të kësaj rregulloreje, dëm i deklaruar quhet dëmi sipas të cilit është kryer pagesa ose është përcaktuar detyrimi i siguroesit (dëmi është raportuar).
3. Periudha e vëzhgimit zgjat një vit nga data e sigurimit.
4. Periudha e vëzhgimit ka filluar së zbatuari nga data 01 korrik 2012.
5. Siguroesi i pranon të siguroarit shkallën e arritur të primit në bazë të informacioneve të gjeneruara nga Qendra Informative e Sigurimeve që administrohet nga Byroja Kosovare e Sigurimit apo informacioneve nga subjekte tjera të pranueshme për BQK-në.
6. Kur i siguruari lidh sigurimin nga autopërgjegjësia për herë të parë, paguan premin e shkallës themelore njëmbëdhjetë (11) të përcaktuar nga paragrafi 9 i këtij neni.
7. Nëse i siguruari ka qenë i siguruar të paktën një vit dhe nëse në periudhën e vëzhgimit nuk ka pasur dëme të deklaruara, të siguroarit për vitin pasardhës i aplikohet primi për një shkallë më i ulët, por jo më shumë se deri në shkallën e parë (1) të përcaktuar me paragrafin 9 të këtij neni.
8. Për çdo dëm të deklaruar në periudhën e vëzhgimit pavarësisht nga kohëzgjatja e sigurimit, të siguroarit për vitin pasardhës i aplikohet primi për tre (3) shkallë primi më lart, por jo më shumë se deri te shkalla e nëntëmbëdhjetë (19), ashtu siç përcaktohet me paragrafin 9 të këtij neni.
9. Shkallët e primit në përqindje që nga shkalla themelore e primit 11 (100%) janë këto:

Shkallët e BONUSIT

Shkallët e MALUSIT

1. 45%

12. 110%

2. 50%

13. 120%

3. 55%	14. 135%
4. 60%	15. 150%
5. 65%	16. 175%
6. 70%	17. 200%
7. 75%	18. 225%
8. 80%	19. 250%
9. 85%	
10. 90%	
11. 100%	

Neni 4

Rregulla tjera për bonusin dhe malusin

1. E drejta për një shkallë të caktuar të primit (bonus/malus) lidhet me të siguruarin, përkatësisht policëmbajtësin dhe nuk kalon te pronari i ri.
2. Të siguruarit, i cili është kategorizuar në një shkallë të caktuar të primit sipas shkallëve të sistemit të bonus malusit të përcaktuar me nenin 3, paragrafi 9, të kësaj rregulloreje sipas policës në fuqi, i pranohet i njëjti kategorizim edhe për çdo mjet motorik tjetër në pronësi të tij brenda të njëjtit grup tarifor sipas nenit 5 të kësaj rregullore.
3. Nëse i siguruari ka lidhur kontratë sigurimi (polica) me afat më të shkurtër se një vit, ajo kontratë në vitin pasardhës nuk mund të jetë bazë për uljen e shkallës së primit.
4. Si përjashtim nga paragrafi 3 i këtij neni, të siguruarit i pranohet shkalla më e ulët e primit sikur të ishte vit i plotë, në rastet kur polica njëvjeçare e sigurimit zëvendësohet nga një policë tjetër e të njëjtit sigurim, jo më shumë se 10 ditë para përfundimit të afatit njëvjeçar të policës.
5. Nëse i siguruari ka lidhur kontratë sigurimi me afat më të shkurtër se një vit dhe nga kjo kontratë është deklaruar dëm, kjo kontratë merret si bazë për ngritjen e shkallës së primit.
6. Nëse kontrata e sigurimit ka skaduar dhe i siguruari nuk kontraktonte policë të re njëvjeçare brenda 15 ditëve nga data e skadimit, atëherë ndaj të siguruarit aplikohet shkalla e njëjtë e primit sikur te kontrata e fundit e skaduar, me kusht që gjatë kësaj periudhe nuk është deklaruar dëm.
7. Nëse kontrata e sigurimit ka skaduar dhe i siguruari nuk kontraktonte policë të re njëvjeçare, pas kalimit të periudhës kohore më shumë se 15 ditë dhe më pak se 45 ditë, nga data e skadimit, atëherë ndaj të siguruarit aplikohet një shkallë më e lartë e primit, por jo më shumë se shkalla 11, krahasuar me shkallën e primit të aplikuar në kontratën e fundit të skaduar, me kusht që gjatë kësaj periudhe nuk është deklaruar dëm.

8. Nëse kontrata e sigurimit ka skaduar dhe i siguruari nuk kontraktonte policë të re njëvjeçare edhe pas kalimit të periudhës prej një 45 ditëve deri në një vit nga data e skadimit, atëherë ndaj të siguarit aplikohet primi dy shkallë më i lartë, por jo më shumë se shkalla bazë e primit (shkalla 11), krahasuar me shkallën e primit të aplikuar në kontratën e fundit të skaduar, me kusht që gjatë kësaj periudhe nuk është deklaruar dëm.
9. Nëse kontrata e sigurimit ka skaduar dhe i siguruari nuk kontraktonte policë të re njëvjeçare prej një vit e më shumë nga data e skadimit, atëherë i siguruari e humb të drejtën e përfitimit të shkallës më të ulët të primit, dhe rikthehet në shkallën bazë të primit (shkalla 11), me kusht që gjatë kësaj periudhe nuk ka dëm të raportuar.
10. Në rastet kur i siguruari ka qenë i kategorizuar në një shkallë të malusit dhe nuk kontraktonte policë të re njëvjeçare brenda periudhës trevjeçare nga data e skadimit të policës së fundit, atëherë i siguruari rikthehet në shkallën bazë të primit (shkalla 11), me kusht që gjatë kësaj periudhe nuk ka dëm të raportuar. E njëjta procedurë aplikohet edhe në rastet kur siguruesi ka bazë ligjore për të refuzuar dëmin, pas raportimit të dëmit.
11. Në rast se i siguruari është kategorizuar në një shkallë të malusit dhe më pas arrin të dëshmojë të kundërtën përmes vendimit gjyqësor, siguruesi duhet që përveç korigjimit të shkallës së primit, gjithashtu të kthejë pjesën e paguar të primit proporcionalisht me korigjimin e bërë. E njëjta procedurë aplikohet edhe në rast kur pas raportimit të dëmit, siguruesi ka bazë ligjore për refuzim të dëmit.
12. Dispozitat e kësaj rregulloreje aplikohen edhe për mjetet motorike me lizing, nëse mjete motorik është siguruar në emër të lizingmarrësit. Në rastet kur mjete motorik është siguruar në emër të lizingdhënësit, aplikohen dispozitat e sistemit bonus malus për personat juridikë sikurse është përcaktuar me nenin 1, paragrafi 5, të kësaj rregulloreje.
13. I siguruari ka të drejtë të blejë dëmin nga siguruesi, duke kërkuar nga siguruesi që të mos aplikojë rritje të primit për një dëm të paguar, nëse plotësohen të gjitha kriteret si në vijim:
 - 13.1 Siguruesi ka arkëtuar (rimbursuar) shumën e plotë të dëmit nga i siguruari, të cilën fillimisht ka paguar për palën e dëmtuar. Kjo pagesë duhet të bëhet përmes sistemit bankar, në xhirollogarinë e siguruesit.
 - 13.2 Blerja e dëmit bëhet brenda 45 ditëve nga data kur siguruesi e ka kryer pagesën e dëmit sipas policës së sigurimit.
14. Në rast se siguruesi ka aplikuar shkallë më të lartë të primit bazuar në një dëm të raportuar por të papaguar dhe më pas i siguruari e ka blerë dëmin sipas përcaktimeve nga paragrafi 13 i këtij neni, atëherë siguruesi duhet që, përveç korigjimit të shkallës së primit, të kthejë edhe pjesën e paguar të primit, proporcionalisht me korigjimin e bërë.

Neni 5
Gupet tarifore

1. Për qëllime të kësaj rregulloreje, grupet tarifore të mjeteve motorike klasifikohen si në vijim:
 - 1.1. Grupi I: Automjetet për pasagjer;
 - 1.2. Grupi II: Automjetet kargo – kamionët;
 - 1.3. Grupi III: Autobusët urban dhe ndërurban;
 - 1.4. Grupi IV: Traktorët me regjistrim të detyrueshëm;
 - 1.5. Grupi V: Motoçikletat;
 - 1.6. Grupi VI: Rimorkiot.

Neni 6
Masat ndëshkimore

Shkeljet e dispozitave të kësaj rregulloreje do të jenë subjekt i masave ndëshkimore, në pajtim me nenin 37 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia.

Neni 7
Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja mbi Implementimin e Sistemit Bonus-Malus, e datës 27 korrik 2012.

Neni 8
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga data e miratimit të saj.

Flamur Mrasori

Kryetar i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës